

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është një prej institucioneve më të rëndësishme social-kulturore të Shqipërisë në varësi të MK.

Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë është hapur në vitin 1979 përmes VKM nr. 123 datë 14.05.1979. Ekspozitat dhe fondet e pasura të tij përbëhen nga objekte historike, kulturore e artistike të periudhës mesjetare, që lidhen kryesisht me trashëgiminë e krishterë bizantine dhe pasbizantine. Ikonat, objektet prej guri, koleksioni i objekteve prej metalesh të çmuara, druri të gdhendur, tekstili, letre etj., janë shembuj të një pasurie e larmie vlerash të paçmuara. Në veçanti, koleksioni ikonografik që ky muze posedon, është një nga më të mëdhenjtë në numur (rreth 6.500 ikona) dhe po aq i bukur e i krahasueshëm me gjithë artin tjetër bizantin e pasbizantin të krijuar në territoret fqinje të inkuadruara në ish Perandorinë Bizantine. Kjo trashëgimi e vyer që sot ruhet, mbrohet e studiohet është një prej akteve më kurajoze e të qytetëruara të atyre që bënë të mundur shpëtimin e saj dhe krijimin me to të Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar.

Si pjesë e territoreve të ish- Perandorisë Bizantine, Shqipëria ka trashëguar një kulturë dhe art që lidhet me këtë periudhë të rëndësishme historike. Banorët e territoreve shqiptare ishin nga të parët që përqaftuan fenë e re kristiane dhe si rrjedhojë mori hov zhvillimi i artit ikonografik. Në hapat e parë të ikonografisë në përgjithësi vihen re ndikimet e artit egjiptian, antikitetit grek, romak, sirian, hebraik, dhe më vonë të artit mesjetar perëndimor. Këta elementë thelbësorë dhe ndërtues nuk janë të përdorur në mënyrë të njëjlojtë në të gjitha shkollat e artit bizantin. Strukturat ekonomike dhe shoqërore të këtyre vendeve të ndryshme, feja e tyre e përbashkët dhe mënyra e njëjtë e krijmtarisë artistike, të udhëhequra kryesisht nga shkollat artistike të Kostandinopojës, tregojnë se ky art bën pjesë në atë “familje” të madhe shumkombëshe që do të quhet Perandori e Bizantit. Megjithatë ky unitet artistik nuk e pengoi artin e krishterë rus, serb, bullgar e grek të

paraqesin tiparet e tyre kombëtare. Si rrjedhojë edhe arti shqiptar ikonografik prezanton pjesën më të çmuar të koleksionit të tij, dëshmi të shekujve XIV-XX .

Ikonat më të hershme në Shqipëri, që i kanë rezistuar kohës, janë ato të shek. XII, XIV, të cilat janë anonime. Në Shqipëri ka punuar një numër i madh piktorësh ikonografë dhe freskografë, ku në koleksionin e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar në Korçë (qytet i rëndësishëm shqiptar në juglindje të vendit) janë identifikuar rreth 150 vepra të tilla. Shumë ikonografë shqiptare kanë punuar ikona dhe afreske edhe jashtë vendit, madje deri në Rusi, si psh. ikonografët e gjysmës së parë të shek. XIX gjeneratat – Zengo, si produkt i atelieve të Malit të Shenjtë Athos.

Disa nga autorët më të njohur të periudhës pas bizantine, që kanë lënë gjurmë në ikonografinë shqiptare, janë: Onufri, Nikolla Onufri, Onufër Qiprioti (jo shqiptar), Kostandin Jeromonaku, Simoni i Ardenicës, Mësues Kostandini, Kostandin Shpataraku, Vëllezërit Kostandin e Athanas Zografi etj. Veprat e tyre në ikonë dhe fresk dallohen për tiparet dhe karakteristikat teologjike dhe artistike, në kontekst të pashkëputur me zhvillimet e artit bizantin të kultit. Ndër shumë ikonografë mund të veçojmë Onufrin, si një rast shumë sinjifikativ i shek XVI, i cili është një prej kulmeve të zhvillimit të artit pasbizantin në Shqipëri.

Në kulturën shqiptare një interes gjithnjë edhe më i madh po tregohet për artin e krishtere-ortodoks të shqipërisë gjatë mesjetës deri në fillimet e shek XX. Kjo periudhe kohore paraqet mjeshtër të ndryshëm të ikonografisë, stile artistike të vecanta, shkolla apo atelie që grupohen sipas kohës dhe zonave të ndryshme të shqiperise. Ikona paraqit nje mesazh 3 dimesional: njohja historike, vizioni teologjik dhe vlera artistike.

Projekti për vendosjen e Muzeut të Artit Mesjetar Korçë në një godinë të re ka qenë një iniciativë e Bashkisë Korçë prej vitit 2007. Përmes donacionit të një Fondacionit Grek, Bashkia Korçë bëri të mundur fillimin e punimeve për ndërtimin e muzeut të ri.

Falë përpjekjeve te vazhdueshme të Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Korçë, u bë e mundur që në Tetor të 2014 të alokohet një fond i dedikuar për zhvillimin më tej të këtij procesi të rëndësishëm të cilat bënë të mundur rifillimin e punimeve në infrastrukturën e godinës.

Në zbatim të Ligjit nr. 9386 datë 04.05.2005 “Për muzetë” projekti i ri i muzealizimit të godinës së re ku do të vendoset Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë ka marrë miratimin e Komisionit Shtetëror të Muzeve. Vendimi Nr. 2 date 15.06.2016

PËRSHKRIM I SHKURTËR I AMBIENTEVE TË EKSPOZIMIT

1. Salla Hyrëse është ambienti i parë. Këtu është integruar recepsioni. Aty ka një kolazh abstrakt raftesh për shitje kartolinash, librash, posterash dhe krijime artizanale të artistëve lokalë. Në krahun e majtë tek raftet vendosen kuti me ngjyra që krijojnë efekt si ai i Ronchamp Chapel e Le Corbusier - një atmosferë misterioze dhe ekzotike. Në të djathtë janë tre panele me ngjyrë të zezë ku do të ketë material informativ shkruar me të bardhë. Dyshemeja këtu është me gur të zi.

2 Salla e Artë përfshin modelin e Murit të Madh të Petërsburg-ut dhe Shkallët Qendrore. Ngjyra këtu është e artë dhe në këtë mur do të ekspozohen rreth 70 ikona. Vizitorët mund të lëvizin lirshëm në dyshemenë e drunjtë të kësaj salle dhe të mund të shohin poshtë shkallëve materialin informativ mbi atë që është ekspozuar. Shkallët janë të veshura me mure të drunjta, të rënda që krijojnë një impresion mesjetar.

3 Ballkoni ka një parrak të rëndë të zi dhe një mur të bardhë ku do të ekspozohet rreth 8 ikona të shekullit XIV. Këto ndriçohen nga niveli më i ulët i tavanit. Ky mur të çon tek hapja në të djathtë.

4. Labirinthe i Zi - Pjesa qëndrore e muzeut është konceptuar pjesërisht i errët dhe misterioz me ndriçim individual për secilën ikonë që këto të spikatin në të ertën që i rrethon. Muret janë lyer me të zezë mat dhe me shkëlqim (teknikë japoneze që krijon një efekt poetik). Këtu do të ekspozohen ikona të shekullit XV - XVI, shkolla e Beratit Onufri, Nikolla Onufri, Onufer Qiprioti etj.

5. Salloni i Kuq është një hapësirë sensitive ku të gjitha sipërfaqet janë të kuqe. Në qënder ka një platformë druri mbi të cilën vendoset ikonostasi i Rehovës me 39 ikonat e tij. Prapa tij krijohet një tunel intim ekspozimi. Këtu do të ekspozohen disa ikona të shekullit XVII dhe ikona të shek. XVIII të shkollës së Korçës, Voskopojës dhe Kostandin Shpataraku.

6. Dhoma e Bardhë është ambienti i fundit i ekspozitës. Ajo është e ndriçuar nga i gjithë tavani (sistemin Zumtobel). Këtu do të ekspozohen vetëm tre ikona të rëndësishme që do të mbeten në memorien e vizitorit. Shkallët ose ashensori i kthejnë vizitorët në Hollin Hyrës, ku tani ata do të jenë të frymëzuar të blerë dicka nga suveniret dhe botimet që ofrohen aty.

Muzeu i Artit Mesjetar në Korçë u projektua nga arkitekti Peter Willson dhe Dea Studio.